



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.162, datë 25.07.2024

**PËR
“CAKTIMIN NË DETYRËN E PROKURORIT”**

Bazuar në pikën 1 të nenit 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 39 dhe 41 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe nenin 189, pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë” i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të caktojë zonjën Hava Memko, në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.
2. Të njoftohen për këtë vendim zonja Hava Memko, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. Ky vendim mund të ankimohet brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
5. U shpall në Tiranë, sot më 25.07.2024.



KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj